

Vendim nr. 66 datë 04.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Sandër Beci, Anëtar

Marjana Semini, Anëtare

në datën 04.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (T) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TAULANT XHINI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-738, datë 24.06.2022 të Gjykatës së Lartë; nr. 44, datë 27.04.2016 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 11, datë 27.01.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 31, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Taulant Xhini është proceduar penalisht dhe prej vitit 2013 ka qenë person i

shpallur në kërkim për shkak të masës së sigurimit “Arrest në burg” të caktuar me vendimin nr. 151, datë 15.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Pas veprimeve operative për kapjen e kërkuesit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në datën 04.04.2014 ka regjistruar procedimin penal nr. 197/2014 ndaj tij për kryerjen e veprave penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, në dëm të katër shtetasve, në bashkëpunim, mbetur në tentativë dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuara nga nenet 79/b, 22, 25 dhe 278, paragrafi 4, të Kodit Penal (KP). Në datën 12.04.2014 prokurori ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ka urdhëruar kalimin e akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me arsyetimin se bazuar në nenet 75/a, 83, pika 1 dhe 84 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), hetimi i procedimit penal nr. 197/2014 nuk përfshihej në kompetencën lëndore të saj.

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka pranuar aktet dhe ka regjistruar procedimin penal nr. 131/2014, datë 28.04.2014. Më tej, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 189, datë 28.04.2015, ka vendosur caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” ndaj kërkuesit, e cila është ekzekutuar në datën 06.05.2015.

3. Gjatë hetimeve paraprake, në datën 22.06.2015, prokurori i ka njoftuar kërkuesit, në prani të mbrojtësit të zgjedhur prej tij, akuzat e parashikuara nga nenet 79/b, 22, 25 (katër herë) dhe 278, paragrafi 4, të KP-së. Në të njëjtën datë, prokurori, bazuar në nenin 93, pika 1, shkronja “ç”, të KPP-së, ka vendosur ndarjen e procedimit penal në dy: procedimi penal nr. 131, në ngarkim të kërkuesit dhe procedimi penal nr. 131/1 i vitit 2014 për hetime të mëtejshme, me arsyetimin se hetimet në ngarkim të kërkuesit kishin përfunduar, ndërsa vazhdonin veprimet për identifikimin e bashkëpunëtorit/bashkëpunëtorëve të tjerë. Gjithashtu, prokurori ka arsyetuar se ndarja e procedimeve nuk dëmtonte vërtetimin e fakteve. Në vijim, në datën 06.07.2015 prokuroria ka paraqitur në gjykatë kërkesën për gjykimin e çështjes penale ndaj kërkuesit sipas akuzave.

4. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. 11, datë 27.01.2016, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për veprat penale “Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit”, kryer në dëm të katër shtetasve, në bashkëpunim, mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 79/b, 22 e 25, në lidhje me nenin 23, pika 2, të KP-së dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, të parashikuar nga neni 278, paragrafi 4, i KP-së, duke e dënuar përfundimisht atë me 35 vjet burgim.

5. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr. 44, datë 27.04.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë vetëm

për akuzën e mbajtjes pa leje të armëve luftarake, duke e cilësuar atë sipas nenit 278, paragrafi 5, të KP-së. Ajo ka arsyetuar se neni 278 i KP-së ka ndryshuar si në formulim, ashtu edhe në renditje paragrafësh me anë të ligjit nr. 135/2015, datë 05.12.2015 dhe vendimit nr. 9, datë 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), ndaj për kërkuesin duhej zbatuar dispozita penale më favorizuese bazuar në nenin 3, paragrafi 3, të KP-së. Disponimet e tjera të vendimit, përfshi masën përfundimtare të dënimit penal, janë lënë në fuqi. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-738, datë 24.06.2022, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

7. Në datën 18.01.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Apelit dhe të Shkallës së Parë për Krime të Rënda, si të papajteshme me Kushtetutën.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet gjyqësore të kundërshtuara i kanë cenuar:

8.1. *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

8.1.1. *E drejta për akses*, në kuptimin substancial, pasi Gjykata i Lartë, në respektim të rolit të saj kontrollues si gjykatë ligji dhe parimit të subsidiaritetit, nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij në rekurs të lidhura me vlerësimin e provave që ishin me natyrë kushtetuese.

8.1.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, i garantuar nga neni 142, pika 1, i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij, të cilat gjejnë mbështetje në nenet 4, 8/a, 152 dhe 432 të KPP-së, duke kufizuar artificialisht pretendimet e paraqitura në rekurs.

8.2. *Parimin e prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat e të tria shkallëve kanë vendosur dënimin me bindjen se ai është fajtor pa u mbështetur në prova. Në dosje nuk ekziston asnjë provë direkte që lidh kërkuesin me

veprën penale të kryer, ndaj akuzat në ngarkim të tij kanë mbetur në nivelin e dyshimit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Kolegji vlerëson se kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, sepse ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim individual kushtetues, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe

afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar vendimet gjyqësore që e deklararin atë përfundimisht fajtor dhe e dënonin me 35 vjet burgim për kryerjen e disa veprave penale. Procesi penal është përmbyllur nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00-2022-738, datë 24.06.2022. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimeve të kundërshtuara dhe, për rrjedhojë, ai e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

14. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

15. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se kur individi kundërshton vendime gjyqësore, afati 4-mujor llogaritet nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastet kur ankimi paraqitet nga një individ gjatë vuajtjes së dënimit me burgim, Gjykata e ka mbajtur në konsideratë rrethanën e izolimit, si vështirësi të marrjes dijeni për vendimet gjyqësore me anë të shpalljes në ambientet fizike të Gjykatës së Lartë ose të njoftimit në sistemin elektronik (*shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen konkrete, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 24.06.2022, ndërsa ankimi kushtetues është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 07.12.2022 dhe kërkuesi po vuan dënimin penal në ambientet e IEVP-së, Fier. Kërkuesi ka parashtruar se rekursi i tij është regjistruar në datën 27.05.2016 dhe Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, në datën 24.03.2022 ka vendosur të shtyjë shqyrtimin në një datë tjetër. Ai nuk ka marrë asnjë informacion dhe nuk i është vënë në dispozicion ndonjë liste ose vendimi i arsyetuar i mospranimit, i cili është publikuar në faqen web të asaj gjykate në tetor të vitin 2022 (*shih faqen 6 të ankimit kushtetues*). Ky parashtrim është konfirmuar nga Gjykata e Lartë, sipas së cilës vendimi është bërë i disponueshëm për palët në datën 01.08.2022 dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit në datën 16.09.2022. Në këtë situatë, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

17. Lidhur me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e të drejtave të procesit të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për akses dhe standardit të arsyetimit, si dhe të prezumimit të pafajësisë, të garantuara respektivisht nga nenet 42, 142, pika 1 dhe 30 të Kushtetutës.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit, në kuptim substancial, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë edhe pse ka rol kontrollues, si gjykatë e ligjit dhe në respektim të parimit të subsidiaritetit, ka vendosur mospranimin e rekursit në dhomë këshillimi, duke mos u dhënë përgjigje shkaqeve të tij për vlerësimin e provave, të cilat ishin me natyrë kushtetuese dhe që, në thelb, lidheshin me mosarsyetimin e vendimeve nga gjykatat e faktit, shkeljen e barazisë së armëve në gjykim, mosrespektimin e parimeve kryesore në gjykimin penal, vlerësimin e dyshimeve në favor të të pandehurit, mosdënimin vetëm mbi një provë, prezumimin e pafajësisë, etj. Kolegji vëren se këto argumente lidhen me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka arsyetuar vendimmarrjen e saj, për rrjedhojë ato do të trajtohen në këndvështrim të cenimit të standardit të arsyetimit, i cili së bashku me parimin e prezumimit të pafajësisë, *prima facie*, hyjnë në juridiksionin kushtetuese e, si të tilla, do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

19. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij, të cilat lidhen me mosrespektimin e parimeve të përgjithshme të procesit penal dhe gjejnë mbështetje në nenet 4 dhe 8/a të KPP-së, pas ndryshimeve të këtij kodi në vitin 2017. Gjykatat e faktit kanë pranuar dhe vlerësuar në mënyrë të njëanshme provat e paraqitura nga prokurori dhe kanë konsideruar të pabesueshme provat e paraqitura nga ana e mbrojtësit. Lidhur me këtë shkelje, Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim, por është mjaftuar vetëm me interpretimin e neni 152 të KPP-së, duke kufizuar artificialisht pretendimet e paraqitura në rekurs. Gjykatat e faktit nuk kanë analizuar ekzistencën e rrethanave dhe kanë shkelur procedurat që kanë të bëjnë me institutin e çmuarjes së provave, të parashikuar nga nenet 152 dhe 432 të KPP-së, ndërsa Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve për këto shkelje.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara

dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u takon vendimeve të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit, Gjykata ka pohuar se ato mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 37, datë 19.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit paraqitet i rregullt në formë dhe pasqyron rrethanat e çështjes, shkaqet e rekursit, si dhe pjesën arsyetuese. Në këtë pjesë të fundit, të emërtuar “Vlerësimi i Kolegjit Penal”, në ndryshim nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata e Lartë ka shprehur me arsyetim të kufizuar argumentet për mospranimin e rekursit, duke treguar se nuk ekzistojnë shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Po kështu, ajo ka analizuar në 5 paragrafë të vendimit të saj pretendimet e kërkuesit për shkelje të ligjit procedural dhe që gjykatat e faktit janë mbështetur vetëm në një provë (*shih paragrafët 11 – 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), duke konkluduar se vendimmarrja e gjykatave më ulëta është në përputhje me ligjin procedural penal dhe, si të tilla, nuk ka vend për cenimin e tyre (*shih paragrafin 15 po aty*). Gjithashtu, në tërësinë e tij, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë.

22. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsytimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë

23. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë vendosur deklarin fajtor të tij pa u mbështetur në prova, direkte dhe indirekte. Edhe në rrjedhën kronologjike të veprimeve të analizuara nga gjykatat nuk ekziston provë direkte që lidh kërkuesin me veprën penale të kryer. Po ashtu, nga përmbajtja e vendimeve të ankimuara më së shumti ekziston një dyshim dhe gjykatat duket se e kanë kaluar barrën e provës nga prokurori te kërkuesi. Ato kanë aplikuar dënimin me bindjen se ai ishte fajtor që në fillim të procesit, pa u mbështetur në prova dhe e kanë përqendruar

kontrollin në mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave që ka kryer gjykata që ka gjykuar çështjen në themel.

24. Neni 30 i Kushtetutës parashikon se kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

25. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë ka kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza (*shih vendimet nr. 68, datë 14.11.2016; nr. 8, datë 26.02.2015; nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Parimi i prezumimit të pafajësisë kërkon që deklarimi i fajësisë së të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve në gjykim (*shih vendimet nr. 13, datë 24.04.2018; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme në çështjen konkrete, Kolegji vëren se nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se anëtarët e gjykatave të zakonshme, që kanë shqyrtuar çështjen në ngarkim të kërkuesit, e kanë filluar procesin me paragjykimin se ai ka qenë autori i kryerjes së veprave penale për të cilat akuzohet. Gjykatat e kanë bazuar vendimmarrjen në një sërë provash të administruara gjatë gjykimit, të tilla si thëniet e dëshmitarëve dhe ballafaqimi mes tyre, provat materiale të gjetura dhe të sekuestruara, aktet e ekspertimit, provat me dokumente dhe të tjera. Lidhur me provat e paraqitura nga mbrojtja dhe kërkuesi, thëniet e 9 dëshmitarëve dhe pyetja e të pandehurit, gjykata e shkallës së parë, pasi i ka vlerësuar në raport me njëra-tjetrën dhe me provat e marra dhe të shqyrtuara gjatë gjykimit, i ka çmuar ato të pavërteta dhe për pasojë me mungesë të fuqisë provuese (*shih faqen 22 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Ky vlerësim nuk është ndryshuar nga gjykata e apelit, e cila ka evidentuar se provat janë paraqitur në mënyrë të hollësishme dhe ka çmuar se vendimi duhej të lihej në fuqi (*shih faqet 6 dhe 24 të vendimit të gjykatës së apelit*). Ndërsa, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat më të ulëta kanë kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshme të çështjes, duke administruar dhe shqyrtuar të gjitha provat e kërkuara nga palët dhe që kishin lidhje me çështjen (*shih paragrafin 12 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

27. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se procesi i zhvilluar ndaj kërkuesit nuk rezulton të jetë nisur me bindjen se ai është fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe se gjykatat nuk kanë arritur në asnjë konkluzion *apriori* për fajësinë e tij. Po ashtu, nuk rezulton që gjykatat e

juridiksionit të zakonshëm të kenë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri, kurse provat janë vlerësuar në unitet me njëra-tjetrën. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim të analizës për kriteret paraprahe, Kolegji çmon se çështja nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.